



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Prilajeno/Predato Received/Delivered	16-06-2021	1	viti god year
Organ /Jedinka Org /Unit	Nr Prot Pr Prot No	Shtopa / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KPM SHCK	3134/2021		1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A. nr. 400/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani–kryetar Arben Mehmeti dhe Malsore Gashi Bajraktari, -anëtarë, si dhe Flakron Gashi –Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar e ankesën A.nr. 400/2021, të datës 11.05.2021, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimin rruga „ Dardania”, Apollonia 20 hyrja nr.4, nr. 15, nga Komuna e Fushë Kosovës, kundër organit të punësimit Instituti i Kosovës për Administratë, Publike në çështjen juridike “ Rivlerësim i punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 16.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar** ankesa A.nr.400/2021 e datës 11.05.2021 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anulohet** Formulari për rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2020 i datës 27.04.2021 për ankuesin
- III. Vendimi i KPMSHCK-së** zëvendëson vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 për ankuesin
- IV. Obligohet** Njësia e Burimeve Njerëzore që vlerësimi sipas këtij vendimi të vendoset në dosjen personale të ankuesit.
- V. Obligohet** Drejtoresha Përgjithshme e Institutit të Kosovës për Administratën Publike, që të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditësh nga momenti i pranimit të tij.
- VI. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës,** duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesi më datë 11.05.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 2301/2021 e regjistruar me numër A.nr.400/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet

ankimore se rivlerësimi i punës për vitin 2020 i datës 27.04.2021, i bërë nga Udhëheqësi i tij sipas obligimeve ligjore që rrjedhin nga vendimi i Këshillit A.nr.109/2021 i datës 12.04.2021, përsëri është jo real dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 02.03.2021, me numër protokoll 920/2021 për ankesën e ankuesit të datës 26.02.2015 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse tek Instituti i Kosovës për Administratë Publike, ndërsa me datën 09.03.2021 me numër protokoll 1059/2021, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike, me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A nr.109/2021 e datës 26.02.2021, me numër protokoll 851/2021, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Formulari i Vlerësimit të Rezultateve në punë për vitin 2020; vendimi i datës 07.03.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Plani i Trajnimit dhe Nëpunësit Civil; Inicimi i procedurës disiplinore; Vendimi i datës 19.01.2021, i Komisionit Disiplinor; kundërshtimi i datës 14.01.2021; Vendimi i datës 07.03.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Përgjigjen në ankesë e datës 09.03.2021, me numër protokoll 1059/2021 me shkresat e bashkangjitura; Ankesën e ankuesit të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës datës 11.05.2021; E-mailin e datës 21.04.2021 dërguar nga _____ për ankuesin; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 i datës 27.04.2021; Komentet e të vlerësuarit të datës 28.04.2021; E-mailin e datës 08.03.2021 dërguar nga _____ për ankuesi me korrespondencën prej pesë (5) faqesh; E-mailin e datës 28.02.2018 dërguar nga _____ për ankuesin më korrespondencën prej dhjete (10) faqesh; E-mailin e datës 10.05.2021 me ankesën e bashkangjitur dërguar në KPMSHCK;

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit **është e bazuar, sepse:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të provave të lëndës si dhe duke u bazuar në bazën e të dhënave mbi vendimmarrje, ka konstatuar se ankuesi paraprakisht ka parashtruar ankesë me datë 26.02.2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore se vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2020 nga udhëheqësja e tij i drejtpërdrejt është jo real dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, me ç ‘rast Këshilli për ankesën e lartcekur me datë 26.02.2021 ka nxjerr vendimin A.nr.109/2021 më numër prot:1752/2021 duke aprovuar ankesën e ankuesit dhe duke e anuluar formularin për vlerësimin e rezultateve në punë për vitin 2020 të datës 29.01.2021 dhe njëkohësisht duke e kthyer lëndën në rivlerësim tek udhëheqësja e drejtpërdrejt e tij.

Instituti i Kosovës për Administratë Publike me datë 27.04.2021 dhe numër protokoll:2025/2021 ka njoftuar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, se e kanë pranuar vendimin Këshillit me numër A.nr.109/2021 të datës 12.02.2021 dhe të njëjtin e kanë zbatuar, ndërsa ankuesi është rivlerësuar për rezultatin e punës për vitin 2020 nga Drejtoresha e Përgjithshme e IKAP.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cila pretendon se rivlerësimi përfundimtar i punës për vitin 2020 nga udhëheqësja i drejtpërdrejtë- Drejtoresha e Përgjithshme e IKAP i bërë sipas obligimeve ligjore që rrjedhin nga vendimi i Këshillit A.nr.109/2020 i datës 12.04.2021, është jo real dhe në kundërshtim me dispozitat ligjore, ka konstatuar se ankuesi në bazë të Formularit për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike të datës 27.04.2021 është rivlerësuar me notën e përgjithshme 2.28 (dypikënjëzetetë).

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të ligjshmërisë se pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.21/2020 për Vlerësimin e Rezultateve në Punë për Nëpunësit Civil dhe Nëpunësit e Shërbimeve Publike përkatësisht nenin 6, paragrafi 2 dhe paragrafi 3, ku përcakton se: 2 “Objektivat e punës duhet të jenë konkrete, të matshme, të arritshme, reale dhe të përcaktuara në kohë”. Paragrafi 3 “Objektivat dhe plani i aktiviteteve për arritjen e objektivave përcaktohen me shkrim sipas afateve në paragrafin



Andaj, duke marr parasysh të gjeturat si me lartë si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi për aprovimin e ankesës, anulimin e formularit të rivlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2020 të datës 27.04.2021, ndërsa ankuesit nota e përgjithshme e vlerësimit **2.6 (dypikëgjashhtë)** i vendoset nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Institutit të Kosovës për Administratë Publike në dosjen personale sipas këtij vendimi.

Me dispozitat e nenit 21 paragrafit 1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është përcaktuar se: *“Vendimi i Këshillit është vendim administrativ i formës së prerë dhe zbatohet nga zyrtari i nivelit të lartë drejtues ose personi përgjegjës i institucionit që e ka marrë vendimin e parë ndaj palës”*, dhe me dispozitat e nenit 24 paragrafit 1 të po këtij ligji është përcaktuar se: *“Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit sipas nenit 21 të këtij ligji, Kryetari i Këshillit nxjerr vendim për ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit”*.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A. nr.400/2021

Elakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Estref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtoreshës së Institutit të Kosovës për Administratë Publike;
- Udhëheqësit të Personelit në Institutin e Kosovës për Administratë Publike;
- Arkivit të KPMSHCK-së,

